

Shtyhet thirrja për bursa për praktikë për studentët në kuadër të programit Erasmus + në Universitetin Alexandru Ioan Cuza të Iași, në Rumani për semestrin e dytë të vitit akademik 2021-2022.

Në kuadër të programit Erasmus+ është shtyrë thirrja për aplikime për bursa për praktikë për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin Alexandru Ioan Cuza të Iași, në Rumani, për semestrin e dytë të vitit akademik 2021-2022.

<http://www.uaic.ro/en/>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për praktikë;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Bachelor;

- Master;

Kohëzgjatja:

- Shkëmbimin e studentëve për praktikë (3 muaj);

Fusha e studimit:

Për më shumë informacion klikoni linkun:

<https://www.uaic.ro/en/international/erasmus-programme-with-partner-countries/student-mobility-for-traineeship/>

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (800 EUR në muaj për studentët)
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe /ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Bachelor:

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Listë notash (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Application form, sipas linkut:

<https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Student-Application-Form-ka107.doc>

-Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B2);

- Traineeship Agreement, sipas linkut:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/1.-Learning-agreement-for-Traineeships_incoming.docx

Dokumenti "Traineeship Agreement" plotësohet fillimisht në pjesën "Before mobility", tek seksioni "Commitment" firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +. Nëse studenti bën ndryshime të dokumentit gjatë mobilitetit, pjesa During mobility duhet të firmoset nga personi përgjegjës në fakultet dhe më pas nga personi përgjegjës në Rektorat.

Guida për plotësimin e dokumentit:

https://unitiredu-my.sharepoint.com/:w:/g/personal/iro_unitir_edu_al/Eb135QFronDOhcnKiKKiaxABRceg9vNpS Ft1zM9CRP27lw?e=VxCMIb

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Listë notash e nivelit Bachelor (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Diplomë e nivelit Bachelor;

-Listë notash e nivelit Master (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);

-Letër Motivimi (në gjuhën angleze);

-Application form, sipas linkut:

<https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Student-Application-Form-ka107.doc>

- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B2);

- Traineeship Agreement, sipas linkut:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/1.-Learning-agreement-for-Traineeships_incoming.docx

Dokumenti "Traineeship Agreement" plotësohet fillimisht në pjesën "Before mobility", tek seksioni "Commitment" firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinator Institucional i Erasmus +. Nëse studenti bën ndryshime të dokumentit gjatë mobilitetit, pjesa During mobility duhet të firmoset nga personi përgjegjës në fakultet dhe më pas nga personi përgjegjës në Rektorat.

Guida për plotësimin e dokumentit:

https://unitiredu-my.sharepoint.com/:w:/g/personal/iro_unitir_edu_al/Eb135QFronDOhcnKiKKIaxABRceg9vNpSFtIzM9CRP27lw?e=VxCMIB

Afati për aplikim: 09 Mars 2022

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!